DEKRET
Nr.7353, datë 13.1.1990

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.4625, DATË 24.12.1969
"PËR SHËRBIMIN VETERINAR"

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.4625, datë 24.12.1969 "Për shërbimin veterinar", pas nenit 2 shtohet neni 2/a me këtë përmbajtje:

"Shërbimi veterinar në Ministrinë e Bujqësisë, në komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve, në ndërmarrjet e kooperativat bujqësore, në ndërmarrjet e tjera dhe në njësitë e repartet ushtarake ngarkohet edhe me detyrën e inspektoratit të shërbimit veterinar.

Organizimi, të drejtat dhe detyrat e inspektoratit të shërbimit veterinar caktohen nga Këshilli i Ministrave".

Neni 2

Në nenin 3, paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

"Në ndërmarrjet e kooperativat bujqësore, në ndërmarrjet e tjera, në institucionet dhe në njësitë e repartet ushtarake, me zbatimin e detyrave veterinare ngarkohen punonjësit e tyre të veterinarisë, nën mbikëqyrjen e punonjësve veterinarë të komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve dhe të Ministrisë së Bujqësisë. Përjashtim nga ky rregull bëhet vetëm nga Këshilli i Ministrave".

Neni 3

Në nenin 6, në fund të paragrafit të parë shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

"Karantina vendoset edhe në ekonomitë me kafshë, shpendë e zookultura me vlera racore e ekonomike, që duhet të ruhen të paprekura nga infeksionet".

Neni 4

Në nenin 7 hiqet "lokalitet".

Neni 5

Në nenin 9 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Për ndalimin dhe mënjanimin e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse tepër të rrezikshme të përcaktuara nga Ministria e Bujqësisë, kafshët ose shpendët që janë prekur prej tyre, theren ose vriten dhe groposen".

Neni 6

Neni 13 ndryshohet si vijon:

"Qarkullimi, shtegtimi dhe transportimi jashtë ekonomive, si dhe nga njëri rreth në tjetrin, i kafshëve e i shpendëve të ekonomive e individëve, si dhe i produkteve e nënprodukteve blegtorale, i peshkut dhe i zookulturave, lejohet vetëm kur janë të shoqëruara me certifikatë veterinare, që vërteton

se janë të paprekura nga sëmundjet ngjitëse dhe vijnë nga vende të painfektuara”.

Neni 7

Pas nenit 13 shtohet neni 13/a me këtë përmbajtje:

“Organet e Policisë Popullore dhe inspektorët e shërbimit veterinar kontrollojnë lëvizjen e kafshëve e të shpendëve brenda rrethit. Ata bllokojnë kafshët pa certifikata veterinare dhe i dorëzojnë në ndërmarrjet e grumbullimit të mishit, kurse shpendët pa këto certifikata theren në vend dhe i jepen pronarit për konsum”.

Neni 8

Neni 22 ndryshohet si vijon:

“Shkelja e dispozitave të parashikuara nga nenet 4 deri në 6, 8 deri në 13, 14 deri në 17, 19 e 20 të këtij ligji, kur nuk formon vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me qortim shoqëror ose me gjobë deri në 500 lekë nga inspektorët e shërbimit veterinar të Ministrisë së Bujqësisë, deri në 300 lekë nga inspektprët e shërbimit veterinar të komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve dhe deri në 100 lekë nga inspektorët e shërbimit veterinar të ndërmarrjeve e koperativave bujqësore, të ndërmarrjeve të tjera dhe njësive e reparteve ushtarake.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve nga data e shpalljes së vendimit ose e njoftimit të tij, përkatësisht te ministri i Bujqësisë, kryetari i komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit, drejtuesit e kooperativave e ndërmarrjeve bujqësore, të ndërmarrjeve të tjera, si dhe në komandën e njësive e reparteve ushtarake, aktet e të cilëve janë të formës së prerë”.

Neni 9

Ky dekret hyn në fuqi më 1 shkurt 1990.

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI
Sihat Tozaj

KRYETARI
Ramiz Alia